



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2021:251573

Datë: 23.01.2024

Numri i dokumentit: 05225688

C.nr.948/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN-Departamenti i Përgjithshëm, në përbërje prej gjyqtare Elvira Emimi, si gjyqtare individuale, me bashkëpunëtorin profesional Visar Zeqiri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses E. F. nga S., të cilin me autorizim e përfaqëson Qendrim Rama avokate me seli në Skenderaj, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve Dukagjini me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi, në seancën gjyqësore publike të mbajtur me dt.17.01.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditëses E. F. nga Skenderaj, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve Dukagjini me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e dëmit, në këtë çështje juridike-kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësja E. F. nga Skenderaj, përmes të autorizuarit së saj, në këtë gjykatë me datën 09.11.2021, ka parashtruar padi kundër kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve Dukagjini me seli në Prishtinë, me objekt kontesti rimbursim dëmi.

Lidhur me këtë çështje juridike kontestimore gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit përgatitor për dt.17.01.2024, me fillim në orën 10:15 min, në të cilën nuk ka prezentuar paditësja, edhe pse për të njëjtën kanë ekzistuar provat se është ftuar në mënyrë të rregullt si dhe mungesën e saj nuk e ka arsyetuar.

Gjithashtu në këtë seance nuk ka prezentuar e paditura, edhe pse për të njëjtën kanë ekzistuar provat se është ftuar në mënyrë të rregullt si dhe mungesën e saj nuk e ka arsyetuar.

Ne bazë të nenit 409.1 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), përcaktohet ‘Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet në mungesë të paditësit’.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 409.1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË -DEGA NE LIPJAN
Departamenti i Përgjithshëm**

C.nr.948/21 me datën 17.01.2024

G J Y Q T A R J A
Elvira Emini

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate.